Drive

PORSCHE
ALBANIA

12/15

04
Çmimi "Professor Ferdinand Porsche"
"Professor Ferdinand Porsche Prize" Awards

10
Një ditë trainimi
training day

12
Audi i ri A4
High tech all the way the new Audi A4

16
1 Dekadë në lëvizje
1 Decade in motion

20
SEAT në Panair
SEAT at Motor Show

24
Volkswagen i ri Multivan
The new Volkswagen Multivan

Përmbajtja
Content

3	**I dashur lexues** / Dear Reader
4	**Çmimi "Professor Ferdinand Porsche"** "Professor Ferdinand Porsche Prize" Awards
6	**Fillimi i një dekade të re** / The start of a new decade
8	**Joshja e biznesit** / The chemistry of business
10	**Një ditë trainimi** / A training day
12	**High tech all the way the new Audi** High tech all the way the new Audi
16	**1 Dekadë në lëvizje** / 1 Decade in motion
19	**Një Lojë Shahu** / A chess game
20	**SEAT në Panair** / SEAT at Motor Show
22	**Asnjë Shenjë!** / Not a Sign!
23	**Operator Ekonomik I Autorizuar** Authorized Economic Operator
24	**Volkswagen i ri Multivan** The new Volkswagen Multivan
26	**Në qendër Klienti** Our main concerns are our customer

4

6

10

12

16

20

24

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.
Realizimi: Botues Porsche Albania,
Realizimi grafik: Sourceone

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.SEAT.com,
VW Makina Tregtare:
volkswagen-media-services.com,
VW Das Auto Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com.

Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun.
Telefon: +355 (04) 240 74 30 , Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

I dashur lexues,

Dear Reader,

Fabian Jungnitsch - Drejtor i Përgjitshëm Porsche Albania
General Director Porsche Albania

Më shumë se 3,650 ditë më parë filluam udhëtimin tonë në tregun shqiptar. Ka qenë një udhëtim i karakterizuar nga sfida dhe arritje, teknologji dhe emocione, partneritete dhe rritje. Sot, teksa festojmë përvjetorin tonë të dhjetë, po marrim pak kohë për të hedhur një vështrim pas mbi rrugën e gjatë dhe hera-herës 'të pashtruar' që kemi përshkuar bashkë.

Në këtë numër, e kemi 'rënduar' revistën sepse ka shumë gjëra për të ndarë me ju. Gjatë vitit 2015, jemi rritur në çdo aspekt të biznesit. Jemi rritur në kuptimin e parë të fjalës me sallonet e reja për Audi, Volkswagen dhe automjetet Volkswagen Tregtare, si edhe në kapacitetet e servisit; jemi rritur në kuptimin strategjik duke zënë mbi 33% të tregut total; ndërkohë, jemi rritur në përvojë, duke pasur tashmë një dhjetëvjeçar prej fillimit të punës sonë në tregun shqiptar. Më tepër se 670 makina do dorëzohen tek klientët tanë këtë vit duke e shndërruar 2015 në vitin më të mirë në historinë e kompanisë.

Të gjitha këto evente janë pjesë e një mozaiku që formon atë çfarë Porsche Albania mbështet dhe bën që çdo punonjës të jetë krenar që është pjesë e kësaj skuadre dhe krenar për besimin e klientëve dhe mbështetjen e partnerëve.

Personalisht dua të falenderoj ekipin e Porsche Albania duke i thënë lamtumirë të gjithëve atyre që kanë qenë pjesë e udhëtimit gjatë këtyre 4 viteve e gjysëm, udhëtim që unë e mbyll këtë fund Dhjetori me kthimin në Austri.

Por jini të sigurt që vitet e ardhshme do vazhdojnë të kenë një zhvillim konstat për Porsche Albania. Ne do të modernizojmë sallonin e Porsche Tirana, ku ndodhen showroom-et e ŠKODA dhe SEAT, do të profesionailzojmë tregtimin e makinave të përdorura me markën tonë Das WeltAuto. Përveç këtyre, një bashkëpunim më i afërt manaxherial me kompanitë simotra në rajon do të ndihmojë në krijimin e potencialeve sinergjike si për fushën e shitjes ashtu edhe për servisin. Dhe të gjitha këto mund të realizohen vetëm me pritoritetin për të zhvilluar eksperiencën tuaj dhe të klienteve me Porsche Albania!

E gjithë skuadra e Porsche Albania ju uron ju dhe familjeve tuaja, Krishtlindje dhe Vit të Ri të gëzuar dhe një vit të shëndetshëm dhe të suksesshëm.

Urimet më të përzemërta dhe lexim të këndshëm.

More than 3,650 days ago we started our journey in the Albanian market. A journey marked by challenges and achievements, of technology and emotions, of partnerships and growth. Today while celebrating our tenth anniversary we take a moment to look back at the long and sometimes 'unpaved' road we have driven together.

In this edition we have 'thickened' our magazine as there is a lot to share. During 2015 we have grown in every aspect of business. We have grown literally with the new showrooms for Audi, Volkswagen and Volkswagen Commercial vehicles as well as service capacities, we have grown strategically with a share of more than 33% of the total market and we have grown in experience with now a decade since the start of operations in the Albanian market. More than 670 vehicles will be delivered to our customers within 2015 marking yet another record year of selling cars in Albania.

All this events are small pieces of a mosaic that forms what Porsche Albania stands for and makes everyone working at Porsche Albania proud to be part of this team to receive this ongoing trust from all our customers and support from our partners.

On a personal note I would especially thank and say farewell to everyone that has been part of the journey of Porsche Albania in the last 4 and half years as I will be leaving the company with the end of December and return to Austria.

But be assured the years ahead will continue to show a constant development at Porsche Albania. We will modernize our Porsche Tirana location for the brands of ŠKODA and SEAT, further intensify and professionalize the business area of used cars with our Das WeltAuto Brand. Additionally a closer Management cooperation with our Porsche Sister companies in the neighboring countries will help to create significant Synergy potentials in both the Sales and Service fields. And all of this is done always with the highest priority to enhance your, our customers, experience with Porsche Albania!

The whole team of Porsche Albania wishes you and your families a joyful Christmas and New Year season and a healthy and successful start into the next year.

Best regards and enjoy this Edition of Drive.

Ducati dhe Dainese nderohen me Çmimet "Professor Ferdinand Porsche"

Ducati and Dainese honored with "Professor Ferdinand Porsche Prize" Awards

Një prej çmimeve më të vyera në inxhinierinë e automobilave është akorduar sot nga Universiteti i Teknologjisë I Vienës.

Çmimi i jepet sistemit të parë novator për mbrojtjen e drejtuesit të motorit me airbag: një xhaketë airbag e quajtur D|Air®, dizenjuar fillimisht nga Dainese dhe e përforcuar në një sistem integral mbrojtjeje në bashkëpunim me Ducati. Federico Sabbioni (Ducati Motor Holding S.p.A.) dhe Luigi Ronco (Dainese S.p.A.) ishin fituesit krenarë të Çmimit Profesor Ferdinand Porsche të këtij viti.

D|Air® është një shpikje brilante dhe revolucionare sigurie për motorat. Xhaketa airbag shtrihet për rreth kraharorit të drejtuesit të motorit, mbron shpinën dhe kufizon pendesën e kokës në lidhje me qafën. Sistemi novator i mbrojtjes me airbag komunikon me valë me motorin, duke u lidhur në mënyrë automatike. Një paketë sensori me software algoritmike të posaçme njoftimi arrin të dallojë situatat e rrezikshme, të tilla si përplasje me objekte fikse apo në lëvizje, përplasje nga pas si dhe përplasje për shkak të mungesës së tërheqjes.

Çmimi Profesor Ferdinand Porsche këtë vit u akordua për të 19-ën herë. Çmimi ka vlerën e 50,000 Euro dhe është një prej çmimeve më të shquara për arritje të shkëlqyera në kërkime për inxhinierinë e automobilave. Çmimi i parë u akordua në vitin 1977 nga Louise Piëch, e bija e Profesor Ferdinand Porsche. Paratë e çmimit dhurohen bashkërisht nga Porsche Holding, Salzburg, dhe Dr. Ing.h.c. F. Porsche AG, Stuttgart.

One of the world's most highly endowed prizes in automotive engineering has been awarded by Vienna University of Technology today.

The prize goes to the first ground-breaking airbag rider protection system: An airbag jacket called D|Air®, originally designed by Dainese and enhanced to an integral protection system in association with Ducati. Federico Sabbioni (Ducati Motor Holding S.p.A.) and Luigi Ronco (Dainese S.p.A.) were the proud winners of this year's "Professor Ferdinand Porsche Prize".

D|Air® is a brilliant and revolutionary motorbike safety invention. The airbag jacket extends around the rider's chest, protects the back and limits inclination of the head in relation to the neck. The innovative airbag protection system communicates wirelessly with the vehicle, connecting itself automatically. A sensor unit with a special triggering algorithm software recognises dangerous situations, such as crashes into fixed or moving objects, rear-end collisions as well as crashes due to loss of traction.

The "Professor Ferdinand Porsche Prize" has been presented for the 19th time this year. Worth 50,000 Euros, it is one of the world's best endowed awards for outstanding research achievements in automotive engineering. The first award was donated in 1977 by Louise Piëch, Professor Ferdinand Porsche's daughter. The prize money is being jointly offered by Porsche Holding, Salzburg, and Dr. Ing. h.c. F. Porsche AG, Stuttgart.

MULTISTRADA
1200 S
D|air.

Fillimi i një dekade të re

The start of a new decade

Si kompani që operon në tregun e makinave, ne jemi mësuar me termin shpejtësi. Megjithatë, kur në fillim të vitit rrethuam në kalendar tetorin si muajin për festimin e 10-vjetorit të aktivitetit në treg, them pa rezerva se na përshkoi një ndjesi 'habie,' duke na bërë të lëmë për një moment planet dhe buxhetet e vitit për të kujtuar se sa shpejt kalon koha.
Edhe pse një treg i vogël, Shqipëria ka qënë vazhdimisht në planet e investimeve të Porsche Holding Salzburg. Sot, 10 vjet pas hyrjes në treg, janë investuar rreth 6 milionë Euro për të ngritur dhe forcuar praninë në treg.

Përtej festimeve, ky vit mbart një rëndësi të veçantë për ne. Pas prezantimit ndër këto 10 vite dhe sjelljes në treg të markave Audi, SEAT, ŠKODA, Volkswagen makina tregtare, gjatë 2015 Porsche Albania filloi zyrtarisht shitjen për individët të Volkswagen makina pasagjerësh, si përfaqësues ekskluziv i Volkswagen për Shqipërinë, duke plotësuar portofolin e markave në treg. Por marka e re kërkonte investime të reja dhe të tilla investime nuk munguan për të qenë menjëherë gati për t'u shërbyer klientëve tanë.

Megjithatë, investimet nuk mbetën vetëm tek Audi dhe Volkswagen. ŠKODA, nga dhjetor 2015, po sheh një rinovim tërësor të salloneve përkatëse, ku shumë shpejt klientët e kësaj marke do të shërbehen në mjedise tërësisht të reja.

Por, pak prej këtyre investimeve do të ishin realizuar nëse ecuria në treg e markave tona do të kishte qenë problematike. Shifrat e tre tremujorë këtë vit na bëjnë optimistë për investimet e bëra. Falë besimit të klientëve institucionalë apo individualë, sot Porsche Albania me të gjitha markat e saj zotëron mbi 33% të tregut total të makinave të reja në vend. Marka çeke ŠKODA renditet e para në tregun e makinave të pasagjerëve dhe Volkswagen Makina Tregtare me rreth 40% të tregut të makinave tregtare lë pas me distancë konkurentët e tjerë në këtë segmet. Ajo çka plotëson kuadrin e trofeve në Shqipëri është edhe performanca e shkëlqyer a Audi-t që e rendit markën me katër rrathë në majat e segmentit premium.

Me shumë kënaqësi shohim se ecuria e mirë në treg nuk është e kufizuar vetëm brenda kufijve tanë. Në fillim të dhjetorit, Porsche Albania u vlerësua me çmimin e parë si Importuesi më i mirë i Vitit për vitin 2014 (për tregjet e vegjël) nga Volkswagen Makina Tregtare (trofe që dorëzua në Poznan – Poloni). Me shumë gjasa, ky çmim pritet të përsëritet edhe vitin tjetër pas ecurisë së mirë edhe gjatë 2015.

Në këto 10 vite kemi dorëzuar mbi 4,700 makina tek klientët tanë dhe partneritetin nuk e kemi parë asnjeherë të kufizuar vetëm tek shitjet. Të gjitha këto makina, shumica e të cilave janë në qarkullim, kanë një partner serioz në servisin me mbi 1,750 metra katror shërbime.

Lëvizja si simbol i misionit tonë në treg prek pothuajse çdo aspekt të punës, ku çdo ditë ndërmerren hapa të rinj për të thjeshtuar apo ulur kohën e shërbimit ndaj klientëve. Një shembull i mirë është projekti pilot më i ri në fushën e logjistikës në Porsche Albania ku ne tashmë presim të jemi subjekt i autorizuar për zhdoganim lokal me statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar. Vlen të theksohet që Porsche Albania do të jetë kompania e parë që merr këtë status në tregun shqiptar dhe ky është një vlerësim që autoritetet doganore kanë për Porsche Albania, në kuadrin e tyre për të modernizuar dhe perfeksionuar, në sherbim te bisnesit, procedurat doganore në Republikën e Shqipërisë.

Ky vit pritet të jetë edhe viti rekord për Porsche Albania nga numri i makinave të dorëzuara tek klientët dhe besimi i klientëve tanë besoj se do të justifikohet plotësisht nga ekipi i Porsche Albania edhe në këtë dhjetëvjeçar të ri në tregun shqiptar.

Për të ngritur sadopak siparin e vitit që presim, vlen të përmenden disa prurje të reja që do të kenë shumë prej markave tona. Audi pritet të sjellë Audi A4 e ri si dhe Audi Q1; SEAT do të debutojë me SUV e parë të kësaj marke. ŠKODA pritet të vazhdojë të ketë një ecuri pozitive ku edhe modeli i prezantuar rishtazi ŠKODA Superb do të kontribuojë në suksesin e markës çeke. Volkswagen Tiguan i ri do të mbledhë të apasionuarit pas këtij modeli dhe Volkswagen Crafter tërësisht i ri do të jetë në shërbim të biznesit tuaj rreth fundit të vitit 2016.

Dhe në fund dua t'ju shpreh JU, partnerëve tanë, klientëve dhe stafit të Porsche Albania, urimet më të mira me rastin e festave te fundvitit. Ju uroj një vit të ri sa më të mbarë e të sukseshëm për ju dhe familjet tuaja.

Gentian Bushati - Drejtor i Përgjithshëm Porsche Albania
General Manager Porsche Albania

As a company operating in the vehicle market, we have gotten used to the term speed. Nevertheless, at the start of the year, when we noted down October as the month for celebrating the 10th anniversary of operations in the market, I will say without reservation that a feeling of 'perplexity' grabbed us, making us halt for a moment on plans and budgets of the year to just recall how fast time goes by.

Although a small market, Albania has constantly been in the investment plans of Porsche Holding Salzburg. Today, 10 years after entering the market, a total of 6 million Euros have been invested to establish and consolidate in the market presence.

Aside from celebrations, this year bears special significance for us. After the entry in these 10 years and after bringing to the market the brands Audi, SEAT, ŠKODA, Volkswagen commercial vehicles, during 2015 Porsche Albania officially began selling Volkswagen commercial vehicles to individuals as an exclusive representative of Volkswagen for Albania, thus completing the portfolio of brands in the market. However, the new brand needed new investments and such investments did come in order to be immediately at the service of our customers.

Investments were not confined solely to Audi and Volkswagen. From December 2015, I see a total renovation of the respective showrooms where very soon, the clients of ŠKODA will be served in completely new premises.

Yet, little of these investments would have taken place if the progress of our brands in the market had been problematic. Figures from the three quarters this year make us optimistic about our investments. Thanks to the confidence of our institutional or individual customers, today Porsche Albania and all its brands hold over 33% of the total market of new vehicles in the country. Czech brand ŠKODA ranks first in the market of passenger vehicles and Volkswagen Commercial Vehicles with about 40% of commercial vehicles leads by a large distance other competitors in this category. What completes the panorama of trophies in Albania is also the excellent performance of Audi, with the four-rings brand ranking at the highest part of the premium segment.

We note with great pleasure that progress in the market is not confined within our borders. In the beginning of December, Porsche Albania was awarded the first prize as the best importer for 2014 (for small markets) by Volkswagen Commercial Vehicles (a trophy delivered in Poznan – Poland); it is quite likely that the prize will be re-awarded the following year, given the very good performance even during 2015.

During these 10 years, we have delivered over 4,700 vehicles to our customers and we have never seen partnership as confined to sales alone. All of these vehicles, the majority of which are in circulation, have a serious service partner and over 1,750 square meters of service space.

Movement as a symbol of our mission in the market touches upon almost every aspect of work, with every day featuring new steps to simplify or shorten the time of service needed for our customers. A good example is the new pilot project in the area of logistics at Porsche Albania – we expect to be an authorized operator for local customs clearance with the Authorized Economic Operator status. It is worth stressing that Porsche Albania will be the first company to assume this status in the Albanian market and this is an evaluation that Customs authorities have for Porsche Albania, in their attempts to modernize and perfect customs procedures in the Republic of Albania to better serve businesses.

We expect this year to be a record one for Porsche Albania in terms of the number of vehicles delivered to customers and the confidence of our customers will be fully justified by the team of Porsche Albania even during this new decade of our operations in the Albanian market.

For a little bit of a preview into the new year, it is worth mentioning some new arrivals for many of our brands. Audi is expected to bring the new Audi A4 and Audi Q1; SEAT will debut with the first SUV of this brand. ŠKODA is expected to continue to see positive progress with the recently introduced model ŠKODA Superb contributing to the success of the Czech brand. The new Volkswagen Tiguan will bring together its enthusiasts and the entirely new Volkswagen Crafter will be available to your businesses by the end of 2016.

In the end, I would like to express to YOU, our Partners, customers and staff of Porsche Albania, the best wishes for the Holidays. I wish you the best and most successful year possible for you and your families.

Testi më i vështirë për cilëndo kompani që pretendon sukses në biznesin me shumicë është të ketë klientë shumë të kënaqur që janë gati të mendojnë të blejnë përsëri nga kjo kompani. Tek Porsche Albania, ky rregull është përditësuar dhe aplikuar për disa nga klientët më kërkues që duan besueshmëri, qëndrueshmëri dhe vlerën më të mirë për njësi kostoje

Në një partneritet të ri me Policinë e Shtetit, Das Auto është përzgjedhur për t'iu bashkuar burrave dhe grave trima të policisë Shqiptare në sfidat e tyre të përditshme.

Në dhjetëvjetorin e hyrjes në tregun shqiptar, një numër në rritje klientësh me numra të mëdhenj kanë vendosur ose përforcuar partneritetin me kompaninë austriake.

Sot, 60% e kompanive taksi që funksionojnë në Shqipëri përdorin ekskluzivisht market që përfaqëson Porsche Albania në treg, duke nënkuptuar kështu një pohim të qartë të perceptimeve që klientët kanë për Porsche Albania.

“Pavarësisht nëse është Policia e Shtetit, taksitë, shërbimet postare, kompani transporti apo infrastrukture, të gjitha kanë një emërues të përbashkët. Të gjitha kërkojnë partnerin më të besueshëm në industry dhe pikërisht këtu Porsche Albania qëndron në majë të listës,” komentoi Gentian Bushati, Menaxher i Përgjithshëm tek Porsche Albania.

Gjuha e biznesit

The chemistry of business

The acid test for every company claiming success in the retail business is having enchanted customers that are willing to reconsider buying from this company. At Porsche Albania this rule has been upgraded and applied to some of the most demanding customers seeking reliability, steadfastness and best value per cost unit.

In a renewed partnership with Police Department, Das Auto has been chosen to join the brave men and women of the Albanian Police to their everyday challenges.

In the tenth anniversary of operations in the Albania market an increased number of fleet clients have established or strengthened the partnership with the Austrian company.

Today 60% of the Taxi companies operating in Albania are exclusively using brands - Porsche Albania represents in the market, making a clear statement on the clients perceptions towards Porsche Albania.

“Whether it is Police, taxis, postal services, transport and infrastructure companies the denominator is the same. All these entities are looking for the most reliable partner in the industry, and it is here where Porsche Albania tops the rankings,” commented Gentian Bushati General Manager at Porsche Albania.

Dita nisi si zakonisht. Në 09:00 fiks të gjithë kishin ardhur, dyert e xhamit ishin hapur dhe në sfond mund të dëgjohej muzikë.

Megjithatë një syri të mprehtë do t'i duheshin vetëm pak minuta për të kuptuar që kjo ditë ishte larg të qënit normale.

Fillimisht veshja ishte më e ngrohtë ku xhinset dhe atletet kishin zëvendësuar kostumet e errët, sallonet ishin zbrazur nga makinat dhe vendin e tyre e kishin zënë tryezat e punës, lapsat shënues, flip chartet dhe filxhanët e kafesë. Ekipi kishte dy anëtarë të rinj të cilët nuk i njihnim dhe mbi të gjitha ishte e Shtunë, e cila normalisht është ditë pushimi.

Të paturit e dy godinave, të më tepër markave dhe punonjëve të rinj në kaq pak kohë e bëri të vështirë njohjen ndërmjet kolegëve. Për këtë arsye ekipi drejtues në Porsche Albania së bashku me mbështetjen e Departamentit të Burimeve Njerëzore në Porsche Holding Salzburg konceptuan një trajnim në fundjavë për të mundësuar jo vetëm njohjen në ekip, por edhe për të thelluar më tej bashkëpunimin ndërmjet departamenteve.

Lojrat në ekip dhe seancat e mbledhjes së sygjerimeve zunë pjesën më të madhe të ditës ndërkohë që aktivitetet e tjera nuk shërbyen vetëm për të përfocuar bashkëpunimin në ekip, por shtuan njëkohësisht buzëqeshjen në fytyrat e pjesmarrësve. Një nga këto aktivitete ishte ndarja në ekipe me 5-6 pjesmarrës dhe mbulimi i distancës ndërmjet dy godinave me një fije të pandërprerë spangoje. Dy kilometra, dy godina, 8 ekipe dhe një fill spango.

Michael Liehmann (Doujak Corporate Development) dhe Simone Scheffer (Porsche Holding Salzburg) drejtuan seancat ku pjesmarrësve gjatë të gjithë fundjavës u duhej të shkruanin, vraponin, vizatonin, ngjisnin shënime apo të bënin 'selfie'.
Nënteksti ishte i qartë, tejkalimi i barrierave imagjinare, të kuptuarit e ndikimit dhe rëndësisë së çdo anëtari të ekipit, por edhe të kaluarit e një dite plot humor.

Dhe si çdo trajnim i denjë duhej patjetër që mbrëmja të plotësohej nga festime plot ngjyra, kërcime ekzotike dhe humor.

Suada Mukja
Drejtuese e Burimeve Njerëzore

The day started as usual. At sharp 9:00 am everybody had clocked in, the building glass doors were open and music could be heard in the background.

However to an attentive eye it would only take a while longer to note that the day was far from being normal.

First the outfit was more 'relaxed' where jeans and sneakers have replaced the usual dark suit, the showrooms were emptied from the vehicles and fitted with tables, markers, flip charts and coffee caps. There were two new team member joining the group that we didn't know and above all it was Saturday a normal day off.

Having two buildings more brands and more employees in such a short period of time made it difficult for the team to get to know each other. For this reason the general management at Porsche Albania with the support of the Human Resources Department at Porsche Holding Salzburg design a training weekend to help people not only meet everyone else on the team but to improve the cooperation between departments as well.

Team spirit games and suggestions sessions marked most of the day while several activities proved not only to improve the bonding between colleagues but print some smiles on the portraits of the participants as well. One of these was covering the distance between our two buildings in teams of 5-6 people holding a thread. Two kilometers, two building, 8 teams and one uninterrupted thread.

Michael Liehmann (Doujak Corporate Development) and Simone Scheffer (Porsche Holding Salzburg) guided the sessions where writing, running, drawing, sticking notes and taking selfies got the team engaged during the whole weekend.

The underlying motives were clear, overcoming mental barriers, realizing the affect and importance each team member had on the group and finally having a good time together.

As any respective training would have it a colorful party with exotic belly dances, standup comedy and a lot of dancing marked the end of the training weekend.

Suada Mukja
Head of Human Resources

Një ditë trajnimi

Training day

High tech all the way
Audi i ri

High tech all the way
the new Audi

Më i fuqishëm, më efiçent, më inteligjent! Përkufizimet e duhura për modelin e ri Audi A4.

Ky model i ri vjen me më shumë risi dhe teknologji novatore duke u pozicionuar menjëherë në krye të segmentit ku bën pjesë. Dizajni i A4 të ri ndërthur elegancën klasike të Audi-t me një koncept të ri të kontrollit. Ky konstrukt i ri, më i lehtë dhe i manovrueshëm, është kombinuar me një paletë motorësh shumë efiçentë. Modeli i ri A4 vendos standarte të reja edhe në fushën e multimedias.

Nga jashtë, përmasat atletike dhe eleganca sportive dominojnë A4 e ri. Linja elegante në pjesën e përparme të makinës thekson gjeresinë e saj. Prerjet e sakta dhe linjat e mprehta shprehin elegancën sportive të markës.

Fenerët e parë ofrohen në opsionin LED dhe MATRIX me tregues dinamikë.

Në brendësi, volumi i kabinës si dhe gjerësia në pjesën para dhe pas e bëjnë A4 e ri modelin me hapësirën e brendshme më të madhe në kategorinë e tij.

Dizajni i brendshëm me sipërfaqe të strukturuar, dekor tepër cilësor, ngjyra dhe materiale të reja, hapësira të bollshme, ndriçimi i brendshëm LED që vjen si pjesë e paketës standarte, si dhe shumë detaje të tjera shprehin cilësinë dhe aftësinë e pakonkurueshme të një salloni me të cilin janë familjarizuar tashmë të gjithë ata që përdorin Audi. Interiori dhe sidomos linja e kroskotit thekson konceptin e ri të dizajnit futurist, me linja sportive.

Krahasuar me modelet e mëparshme, përmasat e makinës janë rritur ndërsa pesha është pakësuar me 120 kilogramë. Karroceria e modeleve të reja Audi është ndër më të lehtat në kategorinë e kësaj makine falë një teknologjie të avancuar me materiale të përzier dhe konstruksionit të lehtë. Audi A4 është lider në kategorinë e tij edhe për izolimin e zhurmës dhe filtrimin e vibrimeve.

Risitë teknologjike të A4 të ri përfshijnë kroskotin virtual, dritat e përparme Matrix LED, smartphone interface, Sistemi 3D i audios Bang & Olufsen, kutia e telefonit me lidhje wireless, head-up display, dhe sistemi i ri i asistimit të shoferit.

Motor i fuqishëm gjashtë dhe katër pistonësh.

Audi i ri A4 dhe A4 Avant po prezantohen në Gjermani me 7 tipe motorësh, tre TFSI dhe katër TDI. Fuqia e tyre është rritur shumë dhe varion nga 110 kW (150 kuaj fuqi) në 200 kW (272 kuaj fuqi), por konsumi i karburantit është reduktuar me 21%. A4 me motor 2.0 TDI ka një konsum mesatar karburanti 3.7 litra për 100 kilometra.

Të gjithë motorët kombinojnë efiçencën me fuqi sportive dhe butësi. Kjo aplikohet më shumë tek motorët 3.0 TDI me gjashtë pistona.

Audi i ri A4 sjell një risi për motorët e benzinës: Motori 2.0 TFSI me 190 kuaj fuqi pëdror një mënyrë të re djegieje që e bën mjaft efiçent konsumin me vetëm 4.8 litra për 100 km. Gjatë ciklit të këtij modeli, do të dalë edhe versioni g-tronic cili do të përdorë gaz natyral.

S tronic, tiptronic dhe manual
Motori, kamio, shasia janë rizhvilluar plotësisht. Trasmisioni manual me gjashtë marshe, S tronic me 7 marshe (aktualisht i disponueshëm edhe me rrotat e para aktive) dhe tiptronic me 8 marshe; trasmisioni tani ofron edhe mundesinë për kursim karburanti dhe efiçencë të lartë.
Transmisioni manual me gjashtë marshe, S tronic me shtatë dhe tiptronic me tetë marshe janë ridizenjuar për një përvojë të pa krahasueshme udhëtimi.

Mund të flisnim gjatë për përvojën në drejtimin e Audi-t të ri A4 dhe sërish të mos arrinim ta përcillnim qoftë edhe pjesërisht ndjesinë që të fal një xhiro prove. Audi i ri A4, modeli për t'u provuar.

More powerful, more efficient, more intelligent! The right definitions for the new Audi A4.
The new model features more novelties and innovative technology, being positioned right away at the top of its class. The design of the new A4 blends Audi's classic elegance with a new control concept. The new construction, lighter and more maneuverable, is combined with a set of very efficient engines. The new A4 model also sets new standards in the multimedia field.

On the exterior, athletic proportions and sporty elegance dominate the new A4. The elegant line at the front emphasizes its width. The clear and sharp lines express the car's sporty elegance.
Headlights are offered in the LED and MATRIX options with dynamic indicators.

On the interior, the volume and width in the front make the new A4 the model with the greatest interior space in its category.
The interior design with a structured surface, high quality décor, new colors and materials, ample space, interior LED lighting as part of the standard package, as well as many other details, express the incomparable quality and ability of a brand that all those using an Audi have become familiar with. The interior and particularly the dashboard line enhance the new futuristic design concept with sporty lines.

Compared to previous models, the car dimensions have grown while its weight has been reduced by 120 kilograms. The body of the new Audi models is one of the lightest in its class thanks to the advanced technology of material mix and lightweight construction. The Audi A4 is a leader in its class also in terms of isolating noises and filtering vibrations.

The technological novelties of the new A4 include the virtual cockpit, Matrix LED headlights, smartphone interface, the 3D Bang & Olufsen audio system, the Wi-Fi connection phone box, the head-up display and the new driver assistance system.

Powerful six and four cylinder engines.

The new Audi A4 and A4 Avant will be launched in Germany with seven engines, three TFSI and four TDI. Their power output has been increased considerably and ranges from 110 kW (150 hp) to 200 kW (272 hp), but fuel consumption has been reduced by 21%. The A4 2.0 TDI has fuel consumption of just 3.7 liters for 100 kilometers.

All engines combine high efficiency with sporty power delivery and smoothness. This applies in particular to the 3.0 TDI six-cylinder engines.

The new Audi A4 has an innovation for gasoline engines: The 2.0 TFSI with 190 hp uses a new combustion method that makes it especially efficient and allows fuel consumption of 4.8 liters per 100 km.
During this model's lifecycle, a g-tron version will be launched that will use natural gas.

S tronic, tiptronicand manual transmission
The engine, transmission, and the chassis have been completely redeveloped. The six-gear manual transmission, the 7-gear S tronic (now available also for front-wheel drive) and the eight-stage tiptronic have been redesigned automatic transmissions now offer a fuel-saving and freewheeling function.
The six-gear manual transmission, the seven-gear S tronic transmission and the eight-gear tiptronic have been redesigned for an incomparable driving experience.

We could talk at length about the experience of driving the new Audi A4 and yet again fail to convey even a part of the sensation that a test drive can generate. The new Audi A4, the model to try.

Tërësisht i ri, totalisht uau. Tiguan i ri.

Me teknologjinë më të përparuar 'Connectivity'.

Me më tepër pajisje të "zgjuara" për të shijuar ditën në xhunglën urbane.

Scan

Zbulo më tepër me:
seeMore App

Për më tepër informacion për modelin dhe mundësinë për një xhiro provë na kontaktoni në Volkswagen Tirana.


dhe Android.
ONE WAY

Është traditë tashmë në Porsche Albania që përvjetorët e rëndësishëm të festohen mes partnerëve të biznesit, klientëve dhe miqve.

Me mbi 4,700 makina të reja të shitura deri sot, Porsche Albania renditet si kompania më e madhe e tregtimit të makinave të reja në vend. Gjatë prezantimit të punës në këto 10 vite, Drejtori i Përgjitshëm Z. Gentian Bushati u shpreh: "Sot Porsche Albania vjen si kompania më e madhe e tregtimit të makinave të reja në vend. Në çdo 3 makina të reja të shitura në vend, afërsisht 1 prej tyre ka dalë nga sallonet tona. Suksesi premton thellim pasi prej pak muajsh Porsche Albania filloi zyrtarisht tregtimin e Volkswagen makina pasagjerësh në nivel rishitësi jo thjesht importuesi."

Forcës së markave që kompania përfaqëson në tregun shqiptar i bashkohet edhe energjia dhe profesionalizmi i ekipit të Porsche Albania. Drejtori i Përgjithshëm Z. Fabian Jungnitsch u shpreh "Tërheqja e kandidatëve më të përgatitur do të vazhdojë të jetë një ndër objektivat kryesorë të kompanisë edhe në vitet në vazhdim."

Gjatë fjalimit për të pranishmit, Z. Alain Favey, Drejtor i Përgjithshëm i Porsche Holding Salzburg, bëri një prezantim të investimeve të bëra ndër vite si dhe foli për strategjinë e qartë që Porsche Holding ka për Shqipërinë dhe rajonin.

Radhën e prezantimeve e mbylli Z. Ylli Manjani, në cilësinë e Zëvendës Ministrit të Transporteve, i cili pasi vlerësoi ecurinë e kompanisë në treg, gjeti rastin t'iu bëj një thirrje ambasadorëve të pranishëm që vendet e tyre respektive ta shohin Shqipërinë me përparësi në planet e tyre të investimeve.

Mes tingujve të muzikës, performancave artistike dhe skenografisë së realizuar për këtë aktivitet, të ftuarit patën mundësi të shohin etapat kryesore që Porsche Albania ka përshkruar gjatë këtyre viteve.

"Sot sëbashku nuk festojmë vetëm përmbylljen me sukses të dhjetëvjeçarit së parë të aktivitetit në Shqipëri. Mbi të gjitha, sot festojmë fillimin e dhjetëvjeçarit të dytë," – përfundoi fjalimin Z. Bushati.

1 Dekadë në lëvizje

10 VJET

PORSCHE
ALBANIA

It has now become a tradition at Porsche Albania to celebrate important anniversaries among business partners, customers and friends.

With over 4,700 new vehicles sold to date, Porsche Albania ranks as the largest new vehicle trading company in the country. Talking about the work carried out during these past 10 years, General Director Mr. Gentian Bushati said, “Today, Porsche Albania comes as the largest new vehicle trading company in the country. Out of every 3 new cars sold in the country, approximately 1 of them came out of our showrooms. This success promises even greater success as only a few months ago, Porsche Albania began officially trading Volkswagen passenger vehicles at the reseller level and not just an importer level.”

Joining the strength of brands that the company represents in the Albanian market is also the energy and professionalism of the team of Porsche Albania. General Director Mr. Fabian Jungnitsch told those present, “Attracting the best prepared candidates will continue to be one of the main objectives of the company in the years to come.”

In his remarks for the meeting, Mr. Alain Favey, General Director of Porsche Holding Salzburg provided an overview of investments through the years and talked about the clear strategy that Porsche Holding has for Albania and the region.

Speeches concluded with remarks by Mr. Ylli Manjani in his capacity as Deputy Minister of Transport. After praising the progress of the company in the market, the Deputy Minister took the occasion to call upon present ambassadors to make sure that their countries would see Albania with priority in their investment plans.

In the midst of sounds of music, artistic performances and the program planned for this event, guests had the opportunity to walk through the main stages that Porsche Albania has gone through during these years.

“Today, together we don't just celebrate the conclusion of the first decade of our operations in Albania. Most of all, today we celebrate the start of the second decade,” concluded his remarks Mr. Bushati.

Mendo SIGAL UNIQA

UNIQA GROUP AUSTRIA

Mendo të MBROSH gjithçka që ke PËRZEMËR!

SIGURIMI I SHËNDETIT

për të gjithë familjen mbulon faturat e kujdesit shëndetësor në klinikën apo spitalin që ju zgjidhni.

SIGURIMI I MAKINËS MINIKASKO

DUKE FILLUAR NGA: 50€ në vit

SIGURIMI I SHTËPISË APO BIZNESIT

duke lluar nga 1 Euro për m² /vit.

Tel: +355 4 2233 308, e-mail: info@sigal.com.al, www.sigal.com.al

SIGAL UNIQA

Një lojë shahu
A chess game

Intervistë me drejtorin ŠKODA në Porsche Albania, Z. Bledar Kozma.

I. Sa herë që flitet për pjesën relative të tregut, na vjen ndërmjet ndonjë garë me makina ku fituesi nën euforinë e fitores ngre trofeun apo hap shampanjën duke lagur me a pa vend pjesëmarrësit e tjerë në tribunë. Në sport shpirti sportiv i mbështetur nga kontratat fitimprurëse të sponsorve duket se ngazëllehet nën brohoritjet e sportdashësve apo pankinës së ekipit që i dha fitoren. Përvec simbolikës përse është i rëndësishëm vendi i parë?

Në përgjithësi vendi i parë kurorzon arritjen më të lartë në fushën apo disiplinën përkatëse. Trofeu shkelqyes fsheh pas vetes një punë të jashtëzakonshme te nje ekipi te madh . Nëse flasim për një sportist, orët e panumërta të kaluara duke u ushtruar, regjimi fizik, disiplina përgatitore, dieta e kontrolluar, këshillimi i vazhdueshëm me trajnerin, hartimi i strategjisë dhe ekzekutimi pa gabime. Por jo larg këtij realiteti janë edhe arritjet në drejtime të tjera.

I. Nuk është sekret që ŠKODA në Shqipëri është kurorzuar e para në tregun e makinave të reja të pasagjerëve për vitin 2015 me një pjesë tregu prej mbi 18% (për periudhën Janar-Shtator 2015). Nga vijnë këto shifra, dhe si mund ti kuptojmë ato?

Të dhënat mbi tregun vijnë nga disa burime si nga të dhënat e konçesionarëve, ato të institucioneve financiare e publike. Më pas të dhënat kontrollohen me rezultatet e të 5 markave tona. Në raportin për 9 mujorin e parë të vitit del se marka Ceke pjese e grupit Volkswagen renditet e para për nga numri i makinave të dorëzuara fizikisht ne duart e klienteve tanë në vend me dicka më shumë se 18% të tregut. Konkurenti më afërt për nga renditja ka një pjesë tregu prej 12,9% e kështu me rradhë.

I. Si do e shpjegonit këtë rezultat dhe kujt do ia atribuoni këtë rezultat?

Porsche Albania ka ndjekur një strategji të qartë për makën ŠKODA duke theksuar në publik tiparet e kësaj marke të cilat përputhen shumë me atë çka klienti kërkon. E vlerësuar si marka me raportin më të mirë cilësi/çmim marka Çeke sjell teknologjinë më të mirë të grupit Volkswagen me modelet e zgjuara dhe pozicionim të qartë në treg. Gjithmonë e më tepër individë dhe kompani po gjejnë përgjigjet e kërkesave të tyre tek kjo markë.
Një faktor tjetër është padyshim puna e palodhur e ekipit ŠKODA në Porsche Albania, pa përkushtimin e të cilëve do ishte i vështirë një rezultat i tillë.

I. Nëse tituli si marka e makinës më e shitur në vend ka qënë deri dje objektiv i ditës tuaj të punës, çfarë do të përbënte një faktor motivues për ekipin tuaj gjatë 2016?

Tregu i makinave të reja është si një lojë e vazhdueshme shahu ku taktikat përshtaten pas çdo lëvizje të lojtarit tjetër vetëm se në këtë treg numri i lojtarëve është shumë më i madh. Puna vazhdon pasi çdo ditë ne përballemi me sfida të reja, modele të reja, legjislacion i ri, kufizime por edhe shanse të reja. Objektivi i ekipit që unë drejtor është të kombinojmë të gjithë faktorët e mundëshëm në mënyrë që oferta jonë të sjellë një përfitim real tek klienti. Si të sjellim më tepër vlerë në jetën/ditën e klientit tonë? Përgjigjia e kësaj pyetje do jetë motivimi kyç për vitin që kemi përpara.

Duke falenderuar te gjithe klientet ŠKODA dhe te gjithe ato kompani qe besuan tek marka jone ju uroj nje fundvit te bukur dhe nje nisje sa me te mbare te 2016.

Interview with Mr. Bledar Kozma, Director of ŠKODA at Porsche Albania

I. Anytime one speaks about the relative market share, we think of a car race whereby the winner, euphoric with victory raises the trophy or opens the champagne bottle spraying everyone else on the podium. In sports, a sportive spirit, supported by beneficial sponsor contracts, appears to rejoice under fan cheers or the pit of the team that ensured the victory. Aside from the symbolic meaning, why is first spot important?

B. K. In general, the first spot crowns the highest achievement in the respective field or discipline. The shining trophy hides the extraordinary work of a great team. If we have an athlete in mind, the endless hours of training, the physical regime, the discipline, the controlled diet, the constant counseling with the trainer, designing the strategy and meticulous execution. Achievements in other directions are also not far from this reality.

I. It is no secret that ŠKODA in Albania has been crowned number one in the market of new passenger vehicles for 2015 with a market share of over 18% (for the period January – September 2015). Where do these figures come from and how should we interpret them?

B.K. Data on the market comes from several resources, such as data from authorized dealers, from financial and public institutions. Then, data is checked against results of our five brands. In the 9-month report for the year, it turns out that the Czech brand that is part of the Volkswagen group ranks first in terms of the number of cars delivered physically to the hands of our customers with something more than 18% of the market. The next closest competitor in the ranking has a market share of 12.9% and so on.

I. How do you explain this result and what would you attribute it to?

B.K. Porsche Albania has pursued a clear strategy on the ŠKODA brand, emphasizing in public the features of this car, which fit very well with what hte customer is looking for. Considered the best brand with the best quality/price rapport, the Czech brand brings the best technology of the Volkswagen group with smart models and clear positioning on the market. An ever increasing number of individuals and companies are finding responses to their requirements in this brand.

Another factor is no doubt the work of the ŠKODA team at Porsche Albania, without whose dedication such a result would be difficult.

I. While achieving the title of best-sold car in the country was this year the objective of your workdays, what would be a motivating factor for your team in 2016?

B.K. The new vehicle market is a continued chess game where tactics adjust after every move by the other player, with the difference being that in this market, the number of players is much bigger. Work continues every day as we face new challenges, new models, new legislation, limitations but also new opportunities. The objective of the team that I lead is to combine all possible factors so that our offer will bring real benefit to the customer. We strive to bring more value to the life/day of our customer. The response to this question will be the key motivation for the year ahead of us.

Thanking all the ŠKODA customers and all the companies that trusted our brand, I wish everyone a beautiful yearend and as good a start of 2016 as possible.

LEON **CROSS SPORT**

SEAT shpalosi edhe Leon Cross Sport, i cili kombinon performancën e një makine sportive kompakte me zhdërvjelltësinë e një makine me të gjitha rrotat aktive.

Pajisur me 300 PS fuqi, ky version i ri arrin shpejtësinë nga 0 në 100 km/h në vetëm 4.9 km. “Është një automjet emocionues që shpreh shumë qartë shpirtin e SEAT,” tha Jürgen Stackmann pasi shpalosi propozimin e ri të markës. Makina e re “është frymëzuar nga super e suksesshmja Leon CUPRA, me të gjithë potencialin për përdorim në autostrada, por e guximshme sa të përballet me xhunglën urbane. Është një atlet me performancë të lartë veshur me çizme për çdo terren.”

Modeli Leon Cross Sport konfirmon synimin e SEAT për të qenë i pranishëm në segmente me vëllime më të larta shitjesh dhe fitueshmëri për kompaninë, e cila do të prezantojë fuoristradën e vet të parë në Geneva Motor Show në mars 2016. “Duam të jemi zgjedhja e parë mes klientëve të rinj në shpirt anekënd Europës,” shtoi Stackmann.

SEAT also unveiled the Leon Cross Sport, which combines the performance of a compact sports car with the versatility of a all-wheel drive.

Equipped with a 300 PS output, this new version accelerates from zero to 100 km/h in just 4.9 seconds. “It's an exciting vehicle clearly expressing the spirit of SEAT”, said Jürgen Stackmann after revealing the brand's new proposal. The new showcar “has been inspired by the wildly successful Leon CUPRA, with all the potential for motorway use, but also poised to take on the urban jungle. It's a high performance athlete in trekking boots”.

The Leon Cross Sport confirms SEAT's intention of being present in segments with higher sales volumes and profitability for the company, which will be presenting its first SUV at the Geneva Motor Show in March 2016. “We want to be the first choice among young-spirited customers all over Europe”, added Stackmann.

GAMA **CONNECT**

Gjithmonë online.

Të qënit gjithmonë I lidhur e në kontakt me botën dixhitale është tashmë më tepër se një trend. Është një stil jete. Modelet e reja CONNECT nga SEAT (Mii, Ibiza, Toledo, Leon dhe Alhambra) ofrojnë sistemet më të përparuara për të qënë gjithmonë online. SEAT Connect App një sistem intuitiv dhe e sigurtë për të shfrytëzuar të gjithë teknologjinë që ju duhet.

Always online.

Being always online and in contact with the digital world is now more than ‘trendy’, it is a way of living. The new CONNECT Models by SEAT (Mii, Ibiza, Toledo, Leon and Alhambra) offer the best in class equipement for being always online. SEAT Connect App, an intuitive and secure app for making the most of the technology your day needs.

IBIZA **CUPRA**

Versioni i ri i modelit të mirënjohur u prezantua në panairin e Makinave në Frankfurt.

Karakteri i fortë e sportive buron nga motori 1.8TSI me 192 KF i cili e përshpejton modelin nga 0 në 100 km/h për 6.7 sekonda dhe arrin një shpejtësi maksimaleprej 235 km/h. Por sportiviteti nuk 'takson' konsumin. Modeli vjen me një konsum mesatar prej 6 litrash për 100 kilometra.

The new version of the known model was introduced at the Frankfurt Auto fair.

The strong sports character emerges from the 1.8TSI engine of 192 Hp that accelerates from 0 to 100 km/h in 6.7 seconds and reaches a maximum speed of 235 km/h. The sports character does not 'toll' on consumption. The model comes with an average consumption of 6 liters per 100 km

Mii **FR LINE**

Kush thotë se përmasat kanë rëndësi?

Modeli i vogël i qytetit vjen tashmë me shumë karakter në versionin FR. Lehtësisht i dallueshëm edhe nga lart, Mii FR qëndron mbi disqe 16" dhe nuk e fsheh natyrën sportive. Si brenda edhe jashtë pasioni dhe sportiviteti markohen me të kuqe.

Who says size matters?

The small city model now comes with more character in the FR version. Easily distinguishable even from above, Mii FR stands on 16" wheels and does not hide its sports nature. Both inside and outside, passion and sportiveness are marked in red.

Mii **by MANGO LIMITED EDITION**

Udhëtimi me stil në rrugët e qytetit.

SEAT prezantoi në Frakfurt modelin e dizenjuar në bashkëpunim me firmën e mirënjohur Mango. Në një thurje interesante të teknologjisë me botën e dizajnit Mii nga MANGO vjen në një seri të kufizuar makinash. Janë vetëm 750 të tilla në shitje. Stili vazhdon edhe në ,timon'.

Driving in style in city streets.

SEAT unveiled in Frankfurt the model designed in collaboration with known brand Mango. In an interesting association of technology with the fashion world, Mii by MANGO comes in a limited series of vehicles. There are only 750 such on sale. Style continues even on the 'steering wheel.'

Asnjë shenjë!
Not a sign!

Ervis Vogli
Drejtori i departamentit të bojës dhe riparimeve / *Head of body & paint shop*

Nëse marrim një trafik të rënduar qytetit, drejtues të shkathët por të pavëmendshëm dhe sinjalistikë të vjetëruar, atëherë kemi gjetur recetën perfekte për gërvishtje 'humor-prishëse' të makinës. Në ditët e sotme, ku plani i ditës është më i gjatë se koha në dispozicion, duket sikur bashkë me shtresën e bojës, gërvishtja dinjitoze e makinës na ka gërvishtur planin e ditës apo ditëve në vijim. Raporti i policisë, deklarimi i dëmit tek siguracioni, negociata për një vlerësim të drejtë të dëmit të shkaktuar apo edhe gjetja e një servisi të shpejtë dhe profesional për të mbuluar 'mëkatet' në drejtim tuajat apo 'kolegëve të tjerë drejtues makinash' duket si një rrugëtim pa fund në ditën e ngjeshur të punës.

Prej kohësh, në krah të autostradës Tiranë-Durrës, departamenti i bojës në servisin e Porsche Albania, pret klientë që duan që gërvishtjen, deformimet e llamarinës apo edhe dëmtime më serioze të makinës t'ia lënë të shkuarës sa më shpejt të jetë e mundur.

I vëmendshëm, i qeshur dhe i gatshëm për të ndihmuar prej 10 vitesh, Ervis Vogli, drejtor i departamentit të bojës dhe riparimeve në Porsche Albania, pret klientët që shpjegojnë rëndësinë për ta patur makinën në gjendjen që ishte kur pati dalë nga fabrika në kohën më të shkurtër të mundshme. I ndihmuar nga programe vlerësimi dëmi por mbi të gjitha nga përvoja e gjatë në këtë fushë, Visi (siç e njohin kolegët) vlerëson, pa humbur kohë, dëmin dhe kohën për riparim.

Për këtë proces Visi shprehet: “Në të vërtetë nuk ndalem gjatë për t'i treguar klientit se si do dalë makina nga servisi ynë; mjafton një fjali: Pas riparimit, nuk do jeni në gjendje ta dalloni pjesën e dëmtuar”. Për ta vërtetuar këtë janë një numër i pafund klientësh të cilët pa rezervën më të vogël dëshmojnë për cilësinë e riparimeve në Porsche Albania.

Receta e cilësisë duket se vjen nga përvoja e gjatë në këtë fushë, ekipi profesional që Visi drejton, pajisjet e specializuara si edhe materialet dhe boja më cilësore në treg.

Me raportet fikse, porcionet e bojës që Visi përzien për të gjetur saktë tonalitetin e ngjyrës së makinës për riparim ngjajnë me solucionet magjike të alkimistëve në përzierjet e tyre për të shndërruar pllakën prej plumbi në pllakë të artë.

Frezat, makinat salduese, çekiçët drejtues të llamarinës, të gjithë në kor krijojnë një kakofoni zhurmash që e bën të vështirë bisedën në këtë mjedis. Megjithatë, në çdo fazë duket sikur zhurma që ndjek makinën e dëmtuar drejt rrugës së 'shërimit' ulet për të përfunduar në një ambient, që fare mirë mund të ishte leximi brenda furrës së bojës ku pjesa tashmë e drejtuar 'takon' njërën pas tjetrës shtresat e bojës.

Rezultati përfundimtar? Asgjë më tepër se përshkrimi plot vetëbesim i Ervis Voglit: “Nuk do jeni në gjendje ta dalloni pjesën e dëmtuar”.

If we bring together heavy city traffic, agile but inattentive drivers and old signage, we will have found the perfect recipe for a 'humor-ruining' scratch of the car.

In our days, when the day's agenda is longer than the time available to us, it seems as if the dignified scratch of the car has also scratched the agenda for that day or the following days. The police report, declaring damages to insurance, negotiations for a fair assessment of the damages and finding a fast and professional service to cover the driving 'sins' of yourself or 'other fellow drivers' seems like an endless journey in a busy day's agenda.

For a long time now, next to the Tiranë-Durrës highway, the paint department in the Porsche Albania service receives clients who want to leave the scratch, bumps or other serious car damages to the past in the fastest way possible.

Attentive, smiling and ready to help, Ervis Vogli, head of Porsche Albania's paint and repair department for the past ten years, receives clients who explain how important it is to them to have the car in the same condition as when it first got out of the factory in the shortest time possible. With help from damage assessment programs, but above all by long experience in this area, Visi (as his colleagues know him) assesses without delay the damage and time required for the repair.

Speaking about this process, Visi says: “In fact, I do not spend much time to tell the client what the car will look like after coming out of the service; one sentence is enough: after the repair, you won't be able to tell where the damage was.” This is proven by a countless number of clients who testify to the quality of repairs at Porsche Albania without the slightest reservation.

The recipe for quality appears to come from the long experience in this area, the professional team that Visi leads, the specialized equipment and the highest quality materials and paint available on the market.

Through accurate dosages, the paint portions that Visi mixes to find the exact color tone of the car being repaired seem like the magic solutions of alchemists in their mixes to convert the lead pad to a gold pad.

The milling and welding machines, the dent repair hammers, all in a choir, create a cacophony of noises that makes it difficult to talk in this place. However, in every phase, it seems as if the noise that follows the damaged car on its path to 'recovery' subsides to end up in a place that might as well be a reading spot inside the paint furnace, whereby the repaired dent 'meets' the paint layers one after the other.

The end result? Nothing more than Ervis Vogli's confident statement: “you won't be able to tell where the damage was.”

Operator Ekonomik i Autorizuar
Authorized Economic Operator

Në vitin 2011 kompania "Porsche Albania shpk" u përzgjodh nga autoritet doganore për të qenë pjesë e projektit pilot për Statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar, aktivitet ky i organizuar nga Projekti i Binjakëzimit "Mbështetje për Përafrimin e Procedurave Doganore me Standardet Europiane" si aktivitet i përbashkët mes kompanive që operojnë në treg dhe autoriteteve doganore shqiptare.

Dhe sot pas 4 vitesh, ne jemi në fazën e aplikimit për t'u pajisur me Autorizimin për Zhdoganim Lokal. Ky autorizim do të na shërbejë ne si kompani për të përafruar proceset doganore me standard e kërkuara për pajisje me autorizimin OEA.

Kodi i Ri Doganor, i përditësuar nga 1 janari i këtij viti, ka theksuar konceptin e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO), të cilët kanë disa avantazhe si:

1. Më pak kontrolle fizike dhe /ose dokumentare
2. Thjeshtime doganore (zhdoganim lokal, deklarim i thjeshtuar, thjeshtime tranziti)
3. Përfitime të tërthorta (më pak dërgesa të vonuara, planifikim i përmirësuar, përmirësim i besnikërisë së klientit, përmirësim i sigurisë dhe komunikimit midis partnerëve të zinxhirit furnizues etj)
4. Marrëdhënie të përmirësuara me doganën (akses dhe kontakt për çdo pyetje)
5. I njohur si partner biznesi i sigurtë dhe i mbrojtur
6. Njohje reciproke (të njëjtat përfitime në çdo vend me një program OEA të barasvlefshëm)

Ne si kompani jemi optimistë për përfitimin dhe procedimin e statusit të Operatorit Ekonomik te Autorizuar, pasi i plotësojmë më së miri edhe kushtet e paracaktuara. Ne plotësojmë kushtin e rëndësishëm që lidhet me të kaluarën e biznesit, duke marrë parasysh transparencën dhe korrektësinë në të gjitha detyrimet dhe procedurat doganore. Kompania jonë ka një sistem të pranueshëm të menaxhimit të regjistrimeve kombëtare, regjistrimit të transportit të mallrave dhe masa sigurie lidhur me teknologjinë e informacionit. Gjithsesi, këto nuk do të ishin të mjaftueshme nëse nuk do të kishim aftësi paguese si dhe burime të kualifikuara njerëzore. Stafi i logjistikës në kompaninë tonë operon me sukses prej më shumë se 3 vitesh vetëdeklarimin në sistemin ASYCUDA (Sistemi i automatizuar për të dhënat e doganave).

Duke marrë parasysh situatën aktuale ku ndodhemi, volumin dhe procedurat e punës së përditshme, jemi optimistë se çdo risi që na përafron me proceset doganore të standardeve europiane, do të jenë vetëm një e mirë plus dhe e konsiderueshme në të gjithë zinxhirin e shërbimeve që ofrojmë si kompani. Drejtoria e Përgjithshme na ka përzgjedhur dhe konfirmuar si operator "i besuar". Për këtë arsye çdo instuticion doganor, për ne nuk është thjesht një "monitorues", por një "partner" i domosdoshëm!

Eliverta Kanani
Drejtuese e Logjistikës

Customs authorities selected "Porsche Albania shpk" in 2011 to be part of the pilot project for the Authorized Economic Operator Status, an activity organized by the Twinning Project "Support to Align Customs Procedures with European Standards," a joint activity between companies operating in the market and Albanian customs authorities.

Today, after 4 years, we are in the application phase to obtain Local Customs Clearance Authorization. This authorization will help us as a company to align customs processes with required standards for obtaining an OEA authorization.

The new Customs Code, updated from January 1 this year, emphasized the concept of Authorized Economic Operators (AEO), which have several advantages, such as as:

1. Less physical and/or document-based controls
2. Customs simplifications (local clearance, simplified declaration, transit simplifications)
3. Indirect benefits (fewer delayed shipments, improved planning, improvement of customer loyalty)
4. Improved relations with customs (access and contact for any questions)
5. Recognized as a safe and protected business partner
6. Mutual recognition (same benefits in every country with an equivalent OEA program)

As a company, we are optimistic about obtaining and proceeding with the Authorized Economic Operator status because we very well meet the predetermined requirements. We meet the important condition regarding the past of the business, considering the transparency and correctness in all customs obligations and procedures. Our company has an acceptable national registration management system, records of transport of goods, as well as security measures regarding information technology. Nevertheless, these would not be sufficient if we did not have the payment capabilities and qualified human resources. The logistics staff in our company has been operating successfully for over three years now self-declaration in the ASYCUDA system (ASYCUDA - Automated System for Customs Data).

Taking into consideration the current situation, the daily work volume and procedures, we are optimistic that any novelty that aligns us with customs procedures of European standards would be yet another extra and considerable benefit in the chain of services that we provide as a company. The General Directory has selected and confirmed us as a "trusted" operator. Therefore, for us, every customs institution is not just a "monitor," but an indispensable "partner!"

Eliverta Kanani
Head of Logistics

Ekipi i logjistikës në Porsche Albania
Logistic team at Porsche Albania

The new Multivan

Ka mundësitë më të mira në kategorinë e tij për t'u përshtatur: Shumëvendëshi i ri ofron fleksibilitet unik si për punën e përditshme ashtu edhe për kohën e lirë.

I pajisur me sistemet më të fundit për ndihmën për shoferin, dizajn të brendshëm të cilësisë së lartë dhe sisteme infoargëtimi shumë të volitshme, Shumëvendëshi i ri e ka merituar emrin që ka si transportuesi më popullor i pasagjerëve. Fleksibiliteti maksimal dhe gatishmëria për terrene jashtë asfalti, kombinuar me konceptin novator të udhëtimit dhe konsumin e ulët të karburantit, tani e bëjnë brezin e gjashtë të Shumëvendëshit edhe më eficient.

Nga jashtë.
Dizajni modern me forma të qarta dhe linja të spikatura janë karakteristika të të gjitha modeleve të brezit të gjashtë. Ana ballore e re shkëlqen me shiritat e kromuar në grilën e radiatorit, si dhe me dritat posaçërisht shtangëse. Me anën e pasme të rimodeluar dhe me rrotat e reja aliazhi, brezi i gjashtë e tërheq shikimin nga të gjitha anët.

Nga brenda.
Për modelet e brezit të gjashtë, janë në dispozicion disa variante të ndryshme për pjesën e përparme, në varësi të përdorimit. Zgjidhjet e menduara me zgjuarsi për ngarkesat, dizajni i pastër dhe pamja më e mirë e mundshme nga të gjitha anët nënvizojnë shumëfunksionalitetin e këtyre modeleve. Mundësitë për konfigurim individual për sediljen e shoferit garantojnë drejtim optimal të automjetit.

Sistemet e ndihmës për shoferin.
Sistemet e përparuara të ndihmës për shoferin mund ta ndihmojnë shoferin për të dalluar situate kritike. Mes këtyre është Sistemi i Frenimit Automatik pas Përplasjes, i cili aktivizohet kur dy sensorët e pavarur pikasin një aksident. Kjo shkakton frenimin pas përplasjes, me qëllim parandalimin e përplasjeve dytësore.

Eficenca.
Brezi i ri i motorëve të lë përshtypje me nivelin e ulët të konsumit të karburantit në çdo njësi – dhe çdo gjë ndodh pa e prekur kënaqësinë e drejtimit të automjetit. Për motorët e rinj TDI me standardin Euro 6 të çlirimit të gazrave, Teknologjia BlueMotion është standard. Falë opsionit me katër rrotat aktive 4MOTION dhe kambios me 7 shpejtësi DSG, modelet e brezit të gjashtë mbartin krenarinë e një koncepti drejtimi automjeti unik në kategorinë e tyre.

> Greatest customisation possibilities in its class: The new Multivan offers one-of-a-kind flexibility for the various demands of both everyday work and leisure time.

Equipped with the latest driver assistance systems, a high-quality interior design and convenient infotainment systems the new Multivan earns its reputation as the most popular people carrier. Maximum flexibility and off-road readiness, combined with an innovative drive concept and low fuel consumption, make the 6th generation of the Multivan now even more efficient.

Exterior.
Modern design with clear forms and distinctive lines are characteristics of all the models of the sixth generation. The new front gleams with chrome strips on the radiator grille, as well as the especially striking headlights. With the newly designed tailgate and the new alloy wheels the sixth generation catches the eye from all sides.

Interior.
For the models of the 6th generation, various cockpit versions are available, depending on the respective use. Cleverly thought-out storage solutions, neat design and the best possible all-round vision underline their multifunctionality. Individual configuration possibilities for the driver's seat make for optimal vehicle handling.

Driver assistance systems.
Advanced driver assistance systems can assist the driver in recognising critical situations in advance. Among these is the Automatic Post-Collision Braking System which activates when its two independent sensors detect an accident. It triggers braking after a collision, with the aim of preventing secondary collisions.

Efficiency.
The new generation of engines offers impressively low fuel consumption with every unit – and all without dampening driving pleasure. For the new TDI engines with Euro 6 emissions standard BlueMotion Technology comes as standard. Thanks to the optional 4MOTION all-wheel drive and the 7-speed dual clutch gearbox DSG the models of the sixth generation also boast a drive concept unique in their classes.

Në qendër klienti

Our main concerns are our customer

Është kënaqësi që në përvjetorin tonë të tretë, në tregun e shërbimeve financiare në Shqipëri

të ndajmë eksperiencën tonë positive me ju!

Që nga fillimet tona më 2013, strategjia jonë ka qenë bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të ofertave si dhe në aplikimin të produkteve të reja financiare në tregun e leasing-ut në Shqipëri. Kjo strategji është njohur dhe pranuar nga ju, e besimi juaj na ka lejuar të marrim pozitën e liderit në segmentin e financimit të automjeteve të Grupit të Porsche Albania.

Në kushtet ekonomike në të cilën ne të gjithë ne operojme, përmirësimi i vazhdueshëm i ofertave është i nevojshëm për të arritur rritje të vazhdueshme të biznesit. Përveç kësaj, në konceptin tonë të biznesit – koncepti financiar i produktit që ne ofrojmë - në qendër të vëmendjes vendos klientet dhe nevojat e tyre specifike. Lizingu financiar ose qiraja operacionale janë formuar në përputhje me nevojat e secilit klient, me informacion të qartë e transparent mbi kostot, pagesa minimale të shumës së pjesëmarrjes së klientit. Po kështu, do të donim të theksonim në veçanti procesin e thjeshtë dhe të shpejtë të miratimit të aplikimit për financim, duke siguruar në te njejtin moment financim, sigurimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve - të gjitha në një vend.

Gjatë periudhës së kontrates së qirasë financiare ose asaj operacionale, ekipi Grupit Financiar të Porsche, është në dispozicion të klientit, për të siguruar mbështetje profesionale, konsulence teknike e financiare. Kënaqësia e klientit është prioritet numër 1! Në varësi të markës automjetit, modelit, si dhe formës së financimit (Lizing financiar ose lizing operacional), ne u ofrojmë klientëve tanë paketa të shkëlqyera financimi te cilat reflektojne normën jashtëzakonisht tërheqëse te interesit si dhe paketa të cilat përfshijnë sigurimin KASKO në vitin e pare, TPL, kosto regjistrimi apo kosto të tjera fillestare gjatë vitit të parë të kontratës së qirasë ose në vijim të saj. Po ashtu, në bashkëpunim me kompaninë tonë simotër Porsche Albania, gjatë ketij viti, kemi kryer disa fushata, ku ofertat e përbashkëta në cmimin e blerjes së automjeteve si dhe kushtet e financimit, u kane dhënë mundësine klientëve tanë të gjejnë ekulibra kosto eficentë. Mund të përmendim, fushata VW Caddy, fushata për përvjetorin e 10-të të Porsche Albania, si dhe fushata aktuale që në kemi përsëri për automjetet e pasagjereve për modelet Volkswagen, duke minimizuar për klientët shpenzimet e para fikse në financim dhe të gjitha osionet ekstra që afektojnë uljen e cmimit të automjetit. Nuk kane munguar edhe projektet me modelet e markes Skoda, per klientet tane të besuar, në financim me paketa të personalizua, nen koceptin e Menaxhimit të Flotës.

Sfida jonë për 2016 do të vazhdojë të jetë përsëri, në angazhimin tonë, në krijimin e paketave financiare të personalizuara sipas nevojave të klientëve për automjetet e grupit, permiresimi i shërbimit eficent, transparent dhe i shpejtë në kohë, sjelljen e eksperiencës së grupit tonë për mundësi tërheqëse financimit! Eshtë ky momenti, të falënderojmë klientët tanë të besuar e të vazhdueshëm, si dhe të gjithë lexuesit, partnerët tanë dhe partnerët tanë të biznesit Gëzuar Krishtlindjet dhe një Vit të mirë dhe të begatë 2016 !!!

Ju mirëpresim pranë salloneve të Porsche Albania-s!

Marjola Gurma
Drejtoreshë e Grupit Financiar Porsche në Shqipëri

360° zgjidhje
solutions

> We are very pleased to share our positive experience with you, in our third anniversary on the financial services market in Albania! Since its beginning in 2013, Porsche Finance Group's business strategy is based on constant improvement of offers and finance models, as well as on applying brand new finance products to Albania's leasing market. This strategy has been recognized and accepted by clients whose trust allowed us to take the leader's position in vehicle financing segment for Porsche Albania.

In the economic conditions in which we all work, constant offer upgrade is necessary to achieve constant business growth. Aside from this, our business concept – financing concept which we offer – puts the spotlight on clients and their specific needs. Financing lease or rent offers are formed in accordance with the needs of each client with a clear expenses overview and minimal down payment or deposit. We would especially like to emphasize the simple and fast process of contract approval, and the fact that you can secure financing, insurance and vehicle maintenance – all in one place.

During the financing lease or rent contract period, the whole Porsche Finance Group's team is at the client's disposal, to provide professional support and advising. Client's satisfaction is our number 1 priority! Depending on the the vehicle brand and model, as well as the financing form (financing lease or rent), we provide our clients with excellent financing packages which is reflected in the extremely attractive interest rate and packages which include Casco insurance in the first year of rent or even throughout the rent contract.

Also this year, in cooperation with our sister Porsche Albania, we have successfully carry out several campaigns where offerings discounts on vehicles price and attractive financial parameters, have enabled our customers to find balances cost efficiency. VW Caddy action, actions during 10th anniversary of the Porsche Albania, and as well as the current action for Volkswagen passenger vehicles where we support minimizing intial fixed costs on financing and all extra options that affect decrease prices of vehicle. There have also been projects with models of Skoda Brand with our loyal clients who believe in our group models and financing packages under fleet management concept.

Our challenge for 2016 is on creating financing personalized packages, according to client needs for our group, vehicles, efficient and transparent fast service, and commitment on bringing the experience of our best group experience in financing options!

It is this moment to thank our customers for their trust and loyalty, and also to wish to you, and all readers, our business partners a Merry Christmas and a year of good and prosperous 2016!!!

You are welcome in our Showrooms near Porsche Albania!

Marjola Gurma
Head of Porsche Finance Group Albania

financim
financing

sigurim
insurance

menaxhim flotash
fleetmanagement

SIMPLY CLEVER

ŠKODA

HAPËSIRË DHE STIL, UDHËTIMI QË DUA

ŠKODA e re Superb. Me hapësirën më të madhe në kategorinë e saj.

Një hapsirë e vogël (e shtuar) për komoditetin Tuaj, një hap i madh për ne. Superb-i i ri ka hapsirën më të madhe në sediljen e pasme dhe në bagazh në të gjithë kategorinë e saj. Për t'i shtuar komoditet udhëtimit Tuaj, vijnë sot një gamë e gjerë elementësh të rinj, si edhe një dizajn i jashtëm emocionues. Superb-i i ri "zbret në tokë" për t'Ju dhuruar një udhëtim "jashtë orbite"!

skoda-auto.al **facebook.com/skodaalb**

Konsumi i kombinuar i karburantit dhe emetimet e CO_2: 4.0-6.2 l/100 km, 100-165 g/km

Clever Inside

Kjo është mënyra sesi ŠKODA u a bën, klientëve të saj jetën më të thjeshtë ditë pas dite.

Mbështetëse këmbe 'Lounge'

Dy çadra të integruara në dyer

Smart link